




USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Përmbledhja e Pulsit Publik XXV

2023



Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të pjesëmarrësve në anketë dhe nuk i paraqesin domosdoshmërisht pikëpamjet e UNDP-së apo USAID-it

PËRMBAJTJA

• LISTA E TABELAVE	5
• LISTA E FIGURAVE	5
• PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
• TREGUESIT KYÇ TË PULSIT PUBLIK	9
• DREJTIMI POLITIK	10
• SIGURIA PERSONALE	11
• INDEKSET E DEMOKRATIZIMIT DHE TË BESUESHMËRISË EKONOMIKE	12
• DREJTIMI EKONOMIK	15
• PROBLEMET MADHORE ME TË CILAT PËRBALLET KOSOVA AKTUALISHT	16
• REKRUTIMI NË BAZA MERITORE NË SEKTORIN PUBLIK DHE ATË PRIVAT	18
• PERCEPTIMET PËR KORRUPSIONIN NË SHKALLË TË GJERË	20
• QËNDRIMET KUNDREJT VOTIMIT	22
• DREJTËSIA TRANZICIONALE	25
• METODOLOGJIA	29
• PESHIMI I TOTALEVE TË POPULLATËS	29
• PËRLLOGARITJA E INDEKSEVE	31

LISTA E TABELAVE

TABLE 1	Kënaqshmëria e të anketuarve me institucionet kyçe ekzekutive, legislative dhe gjyqësore në Kosovë.....	9
TABLE 2	Analiza e trendeve të komponentëve të ID-së	14
TABLE 3	Analiza e trendeve të komponentëve të IBE-së.....	15
TABLE 4	Perceptimet për prevalencën e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë.....	21

LISTA E FIGURAVE

FIGURA 1	Kënaqshmëria e të anketuarve me drejtimin politik të Kosovës	10
FIGURA 2	Përqindja e të anketuarve që do t'u bashkoheshin protestave politike....	11
FIGURA 3	Perceptimi i të anketuarve për sigurinë	11
FIGURA 4	Kënaqshmëria e të anketuarve me drejtimin ekonomik të Kosovës.....	12
FIGURA 5	Kënaqshmëria me drejtimin ekonomik të Kosovës.....	16
FIGURA 6	Perceptimet për problemet madhore me të cilat përballet Kosova aktualisht	17
FIGURA 7	Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik	19
FIGURA 8	Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik kundrejt sektorit privat	20
FIGURA 9	Arsyet e të anketuarve për vlerësimin e tyre për shtrirjen e korrupsionit në Kosovë	22
FIGURA 10	Perceptimi i të anketuarve nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë.....	23
FIGURA 11	Perceptimi i meshkujve dhe femrave nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë	23
FIGURA 12	Perceptimi i komuniteteve të ndryshme nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë.....	24
FIGURA 13	Opinionin e të anketuarve për pasqyrimin profesional nga media të trashëgimisë së konfliktit dhe të shkuarës kolektive të Kosovës	26
FIGURA 14	Perceptimi i të anketuarve për ndikimin tek populli i Kosovës nga Marrëveshja për Rrugën drejt Normalizimit të Marrëdhënieve	26
FIGURA 15	Perceptimi i të anketuarve rreth çështjes nëse Marrëveshja për Rrugën drejt Normalizimit të Marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do ta forcojë kohezionin social në Kosovë, zbërthyer sipas gjinisë.....	27

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përmbledhja e Pulsit Publik është publikim gjashtëmuor, i cili prej më shumë se njëzet vjetësh u ofron me paanshmëri institucioneve të Kosovës¹ dhe palëve të interesit të dhëna të besueshme për treguesit kyç në lidhje me perceptimin e qytetarëve për çështjet socio-ekonomike dhe politike, sigurinë dhe mjedisin. Përmbledhja e Pulsit Publik XXV bazohet në të dhënat e mbledhura nga 8 nëntori deri më 27 nëntor 2023 dhe e pasqyron opinionin e më shumë se 1,300 të anketuarve të moshës mbi 18 vjeç. Të dhënat e mbledhura përmes kësaj ankete zërthehen sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike, për të ofruar informacion mbi dallimet e mundshme në perceptimet e qytetarëve për çështje të ndryshme zhvillimore në Kosovë.

Të dhënat e anketës së opinionit të nëntorit 2023 tregojnë se mesatarisht 42.44% e qytetarëve janë të kënaqur me punën e institucioneve qendrore të Kosovës, duke shënuar rënie për 3.32 pikë përqindje krahasuar me prillin e vitit 2023, kur ky numër ishte 45.76%. Kënaqshmëria me performancën e kabinetit ekzekutiv e kapi vlerën prej 41.8% duke shënuar ulje për 4 pikë përqindje krahasuar me prillin 2023 kur ishte 45.8%. Kënaqshmëria me punën e kryeministrit e kapi vlerën prej 48.9%, duke treguar ulje për 2.6 pikë përqindje krahasuar me prillin 2023 (51.5%). Kënaqshmëria me Kuvendin ishte në vlerën prej 38.7% krahasuar me 46.4% në prill 2023. Një rënie pak më e lartë e kënaqshmërisë është vërejtur me Kryetarin e Kuvendit, duke e shënuar vlerën prej 52.2%, krahasuar me 58.3% në prill 2023. Një rënie e kënaqshmërisë është vërejtur edhe me Presidenten, duke e kapur vlerën prej 56.2% krahasuar me 60.3% në prill 2023. Ndërkohë, është shënuar një rritje për 0.3 pikë përqindje me punën e gjykatave (29.3%) krahasuar me nëntorin e vitit 2023 (29%), dhe për 1 pikë përqindje me punën e Prokurorisë (30%) krahasuar me prillin e vitit 2023 (29%).

Në përputhje me rritjen e përgjithshme të të gjithë treguesve të indeksit ekonomik, në anketën e nëntorit 2023, kënaqshmëria me drejtimin ekonomik shënoi rritje prej 2.41 pikë përqindje, duke e kapur vlerën prej 20.2% krahasuar me 17.79% në prill 2023.

Indeksi i Demokratizimit (DI) u rrit për 0.01 pikë (1.49) nga prilli 2023 (1.48). Megjithatë, u shënuar rritje pak më e lartë (0.17) në Indeksin e Besueshmërisë Ekonomike (IBE), i cili e kapi vlerën prej 1.18 krahasuar me 1.03 në prill 2023. Si ID-ja ashtu edhe IBE-ja maten në një shkallë nga 0 pikë (minimumi) deri në 3 pikë (maksimumi), ku vlerat nën 1.5 konsiderohen negative, ndërsa ato mbi 1.5 tregojnë qëndrim pozitiv të shumicës së qytetarëve në lidhje me indekset e demokratizimit dhe ekonomisë.

¹ Për UNDP-në, referencat për Kosovën do të kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999).

Të dhënat e anketës së opinionit të nëntorit 2023 treguan se 29.8% e të anketuarve ishin të gatshëm të protestonin për arsye politike, duke treguar një rënie për 7.8 pikë përqindje krahasuar me prillin 2023. Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike treguan se një numër pak më i lartë i serbëve të Kosovës (30.5%) ishin të gatshëm të protestonin për arsye politike në krahasim me shqiptarët e Kosovës (28.9%) dhe pjesëtarët e komuniteteve tjera të Kosovës (23.5%).

Gjetjet treguan një rënie në ndjenjën e sigurisë në mesin e të anketuarve me 79.73% që ndiheshin të sigurt kur ishin jashtë në rrugë krahasuar me 82.85% në prill 2023. Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë treguan se më shumë meshkuj (80%) sesa femra (78.9%) deklaruan se ndihen të sigurt kur janë jashtë. Ndjenja e sigurisë në mesin e serbëve të Kosovës është rritur (37.8%) krahasuar me 33.8% në prill 2023. Të dhënat tregojnë një hendek prej 43.2 pikë përqindje kur krahasohen nivelet e sigurisë ndërmjet serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës, ku 80.8% e shqiptarëve të Kosovës deklarojnë se ndjehen të sigurt kur janë jashtë në rrugë. Ka edhe një hendek prej 42.4 pikë përqindje kur krahasohen nivelet e sigurisë ndërmjet serbëve të Kosovës dhe komuniteteve të tjera të Kosovës, me 80% që deklarojnë se ndjehen të sigurt kur janë jashtë në rrugë. Në mesin e 37.6% të serbëve të Kosovës që deklaruan se ndjehen të sigurt kur janë jashtë në rrugë, 6.2% deklaruan se ndjehen shumë të sigurt, ndërsa 31.4% deri diku të sigurt. Në mesin e 80.6% të shqiptarëve të Kosovës që raportuan se ndjehen të sigurt, 25.1% raportuan se ndjehen shumë të sigurt, ndërsa 55.7% raportuan se ndjehen deri diku të sigurt. Sa për komunitetet e tjera të Kosovës, nga 80% që raportuan se ndjehen të sigurt, 12.5% raportuan se ndjehen shumë të sigurt, 67.5% raportuan se ndjehen deri diku të sigurt.

Varfëria (28.6%), papunësia (19.2%) dhe çmimet për artikuj të domosdoshëm (8.9%) janë identifikuar si tre çështjet kryesore në Kosovë në nëntor 2023, krahasuar me prillin 2023, kur papunësia me 32.7%, varfëria me 20.1% dhe inflacioni/rritja e çmimeve (11.6%) ishin identifikuar si tri çështjet madhore. Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike treguan se varfëria (28.6%) dhe papunësia (20.2%) si dhe shërbimet shëndetësore (8.9%) janë perceptuar si tre çështjet kryesore nga shqiptarët e Kosovës, ndërsa problemet e hapësirës urbane (19.5%), varfëria (13.8%) dhe marrëdhëniet ndëretnike (11.9%) janë identifikuar si çështjet më të ngutshme nga serbët e Kosovës. Varfëria (29.5%), furnizimi me energji elektrike (14.5%) dhe papunësia (13%) ishin tre çështjet kryesore për pjesëtarët e komuniteteve tjera të Kosovës.

Të dhënat e Pulsit Publik XXV shënuan një rritje të perceptimit pozitiv rreth punësimit në baza meritore në institucionet publike. Gjithsej 28% e të anketuarve besojnë se punësimi në institucionet publike bëhet në baza meritore, krahasuar me 22% në prill 2023.

Të dhënat e anketës së nëntorit 2023 treguan se një numër pak më i lartë i shqiptarëve të Kosovës (59.3%) dhe i serbëve të Kosovës (32.4%) besonin plotësisht ose besonin se Marrëveshja për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të ndikojë pozitivisht në jetën e popullit të Kosovës, krahasuar me 58.3% dhe 24.8% përkatësisht në prill 2023. Teksa 70% e pjesëtarëve të komuniteteve tjera të Kosovës besonin plotësisht ose besonin se marrëveshja do të ndikojë pozitivisht në jetën e qytetarëve të Kosovës në prill 2023, vetëm 62.5% e besonin të njëjtën gjë në nëntor 2023.

Të dhënat shtesë të marra përmes kësaj ankete do të bëhen të disponueshme përmes Platformës për Vizualizimin e të Dhënave të Pulsit Publik dhe ASKData.²

² Platforma për Vizualizimin e të Dhënave: <https://app.powerbi.com/view?r=eyJrIjojNTUzMjMzZjAtNmZlMC00NmQ2LTg3YjAtNmZmOWY2MTNiMTBliiwidCI6ImIzZTVkYjVlTI5NDQtNDgzNy05OWY1LTc0ODhhY2U1NDMxOSIsImMiOj9>

TREGUESIT KYÇ TË PULSIT PUBLIK

Anketa e opinionit e nëntorit 2023 ka treguar se mesatarisht 42.44% e të anketuarve treguan kënaqshmëri me punën e institucioneve qendrore të Kosovës krahasuar me 45.76% në prill 2023, 39.86% në nëntor 2022 dhe 48.43% në prill 2022.

Kënaqshmëria me performancën e kabinetit ekzekutiv e kapi vlerën prej 41.8% duke shënuar ulje për 4 pikë përqindje krahasuar me prillin 2023 kur ishte 45.8%. Kënaqshmëria me punën e kryeministrit e kapi vlerën prej 48.9%, duke treguar ulje për 2.6 pikë përqindje krahasuar me prillin 2023 (51.5%). Kënaqshmëria me Kuvendin ishte në vlerën prej 38.7% krahasuar me 46.4% në prill 2023. Një rënie pak më e lartë e kënaqshmërisë është vërejtur me Kryetarin e Kuvendit, duke e shënuar vlerën prej 52.2%, krahasuar me 58.3% në prill 2023. Një rënie e kënaqshmërisë është vërejtur edhe me Presidenten, duke e kapur vlerën prej 56.2% krahasuar me 60.3% në prill 2023. Ndërkohë, është shënuar një rritje për 0.3 pikë përqindje në kënaqshmërinë me gjykatat (29.3%) krahasuar me nëntorin e vitit 2023 (29%), dhe për 1 pikë përqindje me punën e Prokurorisë (30%) krahasuar me prillin e vitit 2023 (29%).

Treguesit politik		maj-19	nën-19	Prill-20	dhje-20	maj-21	nën-21	Prill-22	nën-22	prill-23	nën-23	Trendi
Kënaqshmëria me kabinetin ekzekutiv	Kabineti Ekzekutiv	17.70%	14.40%	60.70%	21.30%	59.10%	47.60%	47.20%	41.00%	45.80%	41.80%	
	Kryeministri	36.50%	20.70%	65.40%	23.00%	59.50%	53.20%	52.60%	44.90%	51.50%	48.90%	
Kënaqshmëria me legjislativin	Kuvendi	19.60%	18.60%	33.40%	22.60%	52.90%	50.30%	50.20%	39.10%	46.40%	38.70%	
	Kryetari i Kuvendit	23.60%	20.50%	72.40%	46.70%	59.20%	55.40%	54.40%	50.80%	58.30%	52.20%	
Kënaqshmëria me Presidenten	Presidentja	20.40%	21.20%	18.70%	33.90%	63.70%	55.20%	58.40%	56.80%	60.30%	56.20%	
Kënaqshmëria me gjyqësorin	Gjykata	18.70%	13.60%	24.80%	23.00%	34.60%	33.90%	39.10%	24.40%	29.00%	29.30%	
	Prokuroria	16.40%	14.20%	22.30%	23.00%	30.80%	34.00%	37.10%	22.00%	29.00%	30.00%	

TABELA 1 Kënaqshmëria e të anketuarve me institucionet kyçe ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore në Kosovë

DREJTIMI POLITIK

Të dhënat e anketës së opinionit të nëntorit 2023 treguan se një numër i ngjashëm i të anketuarve (23.9%) ishin të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës, krahasuar me atë të shënuar në prill 2023 (23.3%). Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike treguan se teksa 25.2% e pjesëtarëve të komuniteteve tjera të Kosovës dhe 24% e shqiptarëve të Kosovës ishin shumë të kënaqur ose të kënaqur me drejtimin politik në Kosovë, vetëm 10.4% e serbëve të Kosovës e mendonin të njëjtën gjë. Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë treguan se një numër pak më i lartë i femrave (25.4%) krahasuar me meshkujt (22.5%) ishin shumë të kënaqura ose të kënaqura me drejtimin politik të Kosovës.




FIGURA 1 Kënaqshmëria e të anketuarve me drejtimin politik të Kosovës

Një numër më i ulët i të anketuarve ishin të gatshëm të protestonin për arsye politike në nëntor 2023 krahasuar me prillin 2023 (37.6%). Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë treguan se një përqindje më e lartë e meshkujve (35.3%) sesa e femrave (24.3%) ishin të gatshëm të protestonin për arsye politike. Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike treguan një rënie të gatishmërisë për të protestuar në të gjitha grupet etnike, por rënia më e madhe e gatishmërisë për të protestuar ishte te serbët e Kosovës dhe komunitetet tjera të Kosovës. Gjithsej 30.5% e serbëve të Kosovës dhe 23% e pjesëtarëve të komuniteteve tjera të Kosovës ishin të gatshëm të protestonin për arsye politike në nëntor 2023, krahasuar me përkatësisht 40.5% dhe 29.5% në prill 2023.




FIGURA 2 Përqindja e të anketuarve që do t'u bashkoheshin protestave politike

SIGURIA PERSONALE

Pulsi Publik XXV i pyeti të anketuarit për perceptimin e tyre për sigurinë personale kur janë jashtë në rrugë. Të dhënat e anketës së opinionit të nëntorit 2023 treguan një rënie të lehtë për 3.72 pikë përqindje (79.13%) të perceptimit për sigurinë krahasuar me 82.85% në prill 2023. Niveli më i lartë i sigurisë i regjistruar nga Pulsi Publik ishte 86.3%, në prill 2020.




FIGURA 3 Perceptimi i të anketuarve për sigurinë

Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë treguan përqindje pak më të lartë të meshkujve (80.5%) sesa të femrave (79%) që ndihen të sigurt kur janë në rrugë. Përqindje e ngjashme e shqiptarëve të Kosovës (80.8%) dhe pjesëtarëve të komuniteteve tjera të Kosovës (80%) kanë raportuar se ndjehen të sigurt kur janë në rrugë, krahasuar me 37.6% të serbëve të Kosovës. Krahasuar me të dhënat e prillit 2023, është vërejtur një rritje e perceptimit për sigurinë tek serbët e Kosovës, kur ky numër ishte 33.8%. Ndryshe nga serbët e Kosovës, te shqiptarët e Kosovës dhe komunitetet tjera të Kosovës është shënuar një rënie e lehtë e perceptimit për sigurinë krahasuar me prillin e vitit 2023, kur këto shifra ishin përkatësisht 85% dhe 88%.

INDEKSET E DEMOKRATIZIMIT DHE TË BESUESHMËRISË EKONOMIKE

Anketa e opinionit e Pulsit Publik e nëntorit 2023 regjistroi një rritje të lehtë në Indeksin e Demokratizimit (DI) dhe rritje në Indeksin e Besueshmërisë Ekonomike (IBE). Më konkretisht, ID-ja aktuale është rritur për 0.01 pikë (1.49) krahasuar me prillin 2023 (1.48). IBE-ja është rritur për 0.15 pikë (1.18) krahasuar me prillin 2023 (1.03).




FIGURA 4 Kënaqshmëria e të anketuarve me drejtimin ekonomik të Kosovës

Si ID-ja ashtu edhe IBE-ja janë të përbëra nga një numër komponentësh që përdoren për t'i gjeneruar indekset përkatëse. ID-ja përbëhet nga nëntë komponentë të paraqitur në Tabelën 2 më poshtë. Pyetjet për këtë indeks mund të përgjigjen me “Po, plotësisht”, “Po, kryesisht”, “Jo aq shumë”, ose “Aspak”. Tabela 2 e tregon përqindjen e të anketuarve që u përgjigjën me “Po, plotësisht” ose “Po, kryesisht” në nëntë pyetjet. Për të përcaktuar se cilët tregues ndikuan në rritjen e ID-së, të dhënat nga anketa e opinionit e prillit 2023 u krahasuan me ato të gjeneruara në anketat e mëparshme.

Të dhënat treguan se gjithsej 57.29% e të anketuarve pohuan se zgjedhjet në Kosovë janë demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, krahasuar me 62.2% në prill 2023, 69% në nëntor 2022, dhe 73% në prill 2022. Numri i të anketuarve që besonin se Kuvendi e monitoron punën e Kabinetit Ekzekutiv ishte 44.1%, krahasuar me 51.3% në prill 2023, 61% në nëntor 2022 dhe 67.47% në prill 2022. Gjetjet treguan rritje të perceptimit të të anketuarve se sistemi gjyqësor është i pavarur në vendimet e tij, me 32.5% krahasuar me 29.2% në prill 2023. Gjithsej 61.81% kanë treguar se mediat në Kosovë e gëzojnë lirinë e fjalës, krahasuar me 63.7% në prill 2023 dhe 62.02% në nëntor 2022. Në nëntor 2023 është shënuar një rënie në perceptimin se shoqëria civile shërben si një monitorues i sigurtë i zhvillimeve demokratike në Kosovë, kur ky numër ishte 46.84%, krahasuar me 51.3% në prill 2023.

Në anketën e opinionit të nëntorit 2023 është shënuar rritje në besimin se kabineti qendror ekzekutiv punojn sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës (52.7%), krahasuar me prillin 2023 (40.6%). Në mënyrë të ngjashme, në nëntor 2023 është shënuar rritje (49.4%) në besimin se institucionet lokale të Kosovës punojnë sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës, krahasuar me prillin 2023 (46.7%). Është vërejtur rënie në perceptimin nëse Kushtetuta dhe ligjet në fuqi janë demokratike dhe nëse përputhen me standardet e të drejtave të njeriut, me 56.4% që kanë opinion pozitiv në nëntor 2023, krahasuar me 60.3% në prill 2023. Për fund, është vërejtur një rritje prej 1.7 pikë përqindje në opinionin e të anketuarve se proceset demokratike në Kosovë po shkojnë në drejtimin e duhur.

Po kryesisht dhe Po plotësisht	May-19	Nov-19	Apr-20	20-Dec	May-21	Nov-21	Apr-22	Nov-22	Apr-23	Nov-23	Trends
A janë zgjedhjet në Kosovë demokratike dhe në përputhje me standartet ndërkombëtare?	35.60%	62.73%	66.30%	45.87%	70.44%	70.88%	73.42%	69.02%	62.20%	57.29%	
A e monitoron Kuvendi performancën e kabinetit ekzekutiv?	38.10%	38.61%	58.00%	45.56%	60.13%	62.95%	67.47%	61.00%	51.30%	44.01%	
A është sistemi i gjyqësorit në Kosovë i pavarur në vendimet e tij?	21.50%	31.48%	39.70%	36.66%	37.50%	44.88%	41.67%	34.49%	29.20%	32.50%	
A e gëzojnë mediat në Kosovë lirinë e shprehjes?	45.60%	46.66%	69.10%	57.94%	69.24%	60.70%	69.60%	62.02%	63.70%	61.81%	
A shërben Shoqëria Civile në Kosovë si monitorues i sinqertë i zhvillimeve demokratike në Kosovë?	32.60%	34.79%	50.70%	45.77%	56.56%	55.62%	61.89%	49.83%	51.30%	46.84%	
A funksionon qeverisja juaj lokale (komunale) sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës?	29.80%	29.62%	56.70%	41.53%	52.64%	54.88%	55.82%	51.38%	46.70%	49.40%	
A punon kabineti qendror ekzekutiv i Kosovës sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës?	18.10%	24.23%	54.90%	30.61%	54.39%	49.28%	56.78%	44.51%	40.60%	52.70%	
A janë demokratike Kushtetuta e Kosovës dhe ligjet në fuqi dhe a i respektojnë të drejtat e njeriut?	33.40%	40.30%	64.00%	42.82%	58.07%	59.49%	63.05%	59.07%	60.30%	56.40%	
Pavarësisht nga politika e përditshme dhe me vështrimin drejt së ardhmes, a e pranoni se proceset demokratike në Kosovë janë vendosur dhe po shkojnë në drejtimin e duhur?	22.40%	33.01%	42.50%	36.22%	58.65%	55.65%	59.63%	51.00%	47.50%	49.20%	

TABELA 2 Analiza e trendeve të komponentëve të ID-së

Për të përcaktuar se cilët tregues ndikuan në uljen e IBE-së, përgjigjet aktuale pozitive për komponentët e IBE-së u krahasuan me ato të mbledhura në anketat e mëparshme të opinionit, siç tregohet në Tabelën 3 më poshtë. Përgjigjet e mundshme për pyetjet që kanë të bëjnë me IBE-në janë “të favorshme”, “jo të favorshme” dhe “neutrale”.

Gjithsej 15.6% e të anketuarve kishin pritshmëri të favorshme për të hyrat totale të familjeve të tyre brenda gjashtë muajve të ardhshëm, duke u rritur për 1.3 pikë përqindje krahasuar me prillin 2023 (14.3%). Gjithsej 11.5% e të anketuarve bënë vlerësime të favorshme për kushtet aktuale të biznesit, 3.1 pikë përqindje rritje krahasuar me prillin 2023 (8.4%). Një rritje e këndvështrimit pozitiv është vërejtur edhe në mënyrën se si të anketuarit e shohin gjendjen aktuale të punësimit, me 16.2% që kanë opinion pozitiv, krahasuar me 8.2% në prill 2023. Për fund, është vërejtur një rritje edhe në pritshmëritë e të anketuarve në lidhje me kushtet e punësimit – gjashtë muaj nga anketa e opinionit në nëntor 2023 – me gjithsej 16.2% që i shohin si të favorshme.

I favorshëm	May-19	Nov-19	Apr-20	20-Dec	May-21	Nov-21	Apr-22	Oct-22	May-23	Nov-23	Trend
Cilat janë pritshmëritë tuaja në lidhje me të ardhurat totale të familjes suaj gjashtë muaj nga sot?	11.60%	13.70%	14.20%	11.50%	15.90%	15.90%	17.20%	11.20%	14.30%	15.60%	
Cili është vlerësimi juaj i kushteve aktuale të biznesit?	5.50%	9.10%	8.20%	7.20%	4.70%	12.80%	7.30%	8.20%	8.40%	11.50%	
Cili është vlerësimi juaj për kushtet aktuale të punësimit?	5.80%	7.40%	6.60%	5.60%	7.00%	10.80%	6.30%	7.10%	8.20%	16.20%	
Cilat janë pritshmëritë tuaja në lidhje me kushtet e punësimit gjashtë muaj nga sot?	4.60%	12.00%	11.60%	8.30%	18.80%	15.90%	10.50%	8.30%	12.60%	16.20%	

TABELA 3 Analiza e trendeve të komponentëve të IBE-së

DREJTIMI EKONOMIK

Në anketën e opinionit të nëntorit 2023 është vërejtur një rritje pozitive në perceptimin e qytetarëve për drejtimin ekonomik. Gjithsej 20.23% ishin shumë të kënaqur ose të kënaqur me drejtimin ekonomik drejt së cilit po shkon Kosova aktualisht, krahasuar me 17.79% në prill 2023 dhe 10.82% në nëntor 2022. Gjithsej 47.7% e të anketuarve ishin shumë të pakënaqur ose të pakënaqur me drejtimin ekonomik, krahasuar me 57.29% në prill 2023 dhe 57.18% në nëntor 2022.

Përafërsisht i njëjti numër i meshkujve (19.9%) dhe i femrave (20.5%) ishin shumë të kënaqur ose të kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës, ndërsa një përqindje më e madhe e meshkujve (53.5%) sesa e femrave (47.7%) ishin shumë të pakënaqur apo të pakënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës. Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike treguan se komunitetet tjera të Kosovës (28.85%) e kishin nivelin më të lartë të kënaqshmërisë, të ndjekur nga shqiptarët e Kosovës (19.5%) dhe serbët e Kosovës (7.6%). Rrjedhimisht, serbët e Kosovës (56.7%) e kanë nivelin më të lartë të pakënaqësisë me drejtimin ekonomik të Kosovës, të ndjekur nga shqiptarët e Kosovës (48.5%) dhe komunitetet tjera të Kosovës (36.9%).




FIGURA 5 Kënaqshmëria me drejtimin ekonomik të Kosovës

PROBLEMET MADHORE ME TË CILAT PËRBALLET KOSOVA AKTUALISHT

Anketa e nëntorit 2023 i pyeti të anketuarit për problemet më urgjente me të cilat përballet Kosova aktualisht. Tre çështjet kryesore të raportuara gjatë kësaj ankete të opinionit ishin varfëria (28.6%), papunësia (19.2%) dhe çmimet për artikujt e domosdoshëm (8.9%). Shërbimet e kujdesit shëndetësor (8%) dhe problemet e hapësirës urbane (3.8%) ishin ndër pesë problemet kryesore të identifikuara. Përqindja e të anketuarve që e vlerësuan varfërinë si problemin kryesor madhor u rrit për 7.5 pikë përqindje, krahasuar me anketën e prillit 2023, kur varfëria (20.1%) u vlerësua si problemi i dytë kryesor. Ndërsa përqindja e të anketuarve që e shihnin papunësinë si çështjen kryesore madhore u ul për 13.5 pikë përqindje krahasuar me prillin 2023 (32.7%).

Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë treguan se ndryshe nga anketa e prillit 2023 kur 37.7% e femrave dhe 27.8% e meshkujve e renditën papunësinë si çështjen kryesore madhore, në anketën e nëntorit 2023 si meshkujt (28.2%) ashtu edhe femrat (28.4%) e renditën varfërinë si problemin kryesor madhor. Të dhënat e nëntorit 2023 treguan se femrat ishin më të shqetësuara për papunësinë dhe çmimet për artikujt e domosdoshëm (përkatësisht 21.7% dhe 9.4%), krahasuar me meshkujt (përkatësisht 16.3% dhe 8.5%).

Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike treguan se varfëria u rendit si problemi

kryesor nga shqiptarët e Kosovës (28.6%) dhe komunitetet tjera të Kosovës (29.5%), ndërsa problemet e hapësirës urbane (19.5%) u renditën si problemi kryesor nga serbët e Kosovës. Teksa papunësia ishte çështja e dytë më urgjente për 20.2% të shqiptarëve të Kosovës dhe 13.8% të serbëve të Kosovës, energjia elektrike u rendit e dyta nga 14.5% e pjesëtarëve të komuniteteve tjera të Kosovës.




FIGURA 6 Perceptimet për problemet madhore me të cilat përballet Kosova aktualisht

REKRUTIMI NË BAZA MERITORE NË SEKTORIN PUBLIK DHE ATË PRIVAT

Anketa e opinionit e nëntorit 2023 tregoi rritje për gjashtë pikë përqindje në perceptimin e të anketuarve për punësimin në baza meritore në sektorin publik. Gjithsej 28% e të anketuarve në nëntor 2023 besojnë se punësimi në institucionet publike bëhet në baza meritore, krahasuar me 22% në prill 2023 dhe 27% në nëntor 2022. Kur u pyetën se çka është më e rëndësishme për punësimin në sektorin publik, ngjashëm me anketën e mëparshme, përkatësia partiake (34.1%), dhe lidhja familjare (23%) ishin dy përgjigjet kryesore, ndjekur nga arsimi (17.3%), ryshfeti (7%), miqtë (6.9%), trajnimet profesionale (5.7%), përvoja profesionale (4.8%) dhe paraqitja e jashtme (1.1%).

Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë tregojnë se meshkujt (29.1%) kanë më shumë besim në punësimin në baza meritore në sektorin publik sesa femrat (26.6%). Ngjashëm me anketat e mëparshme, si për meshkujt ashtu edhe për femrat, përkatësia partiake ishte mënyra më e dobishme për ta gjetur një vend pune në sektorin publik, me përkatësisht 35.7% dhe 32.7%,

Ngjashëm me anketat e mëparshme, të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë se përkatësia partiake duket se është faktori kyç për sigurimin e punësimit për shqiptarët e Kosovës (34.4%) dhe serbët e Kosovës (23.1%), kurse për komunitetet tjera të Kosovës është arsimi (23.5%) që e mundëson punësimin në sektorin publik. Të dhënat e nëntorit 2023 treguan se komunitetet tjera të Kosovës (47%) e kanë renditjen më të lartë në perceptimin pozitiv për punësimin në baza meritore, të ndjekur nga serbët e Kosovës (38.3%) dhe shqiptarët e Kosovës (26.8%).




FIGURA 7 Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik

Ndryshe nga perceptimet për punësimin në sektorin publik, gjithsej 54% e të anketuarve besojnë se punësimi në sektorin privat fitohet në baza meritore. Përvoja profesionale perceptohet si kriteri më i dobishëm për punësimin në sektorin privat nga 31.4% e të anketuarve. Të anketuarit i identifikuan faktorët e mëposhtëm jo-meritorë për të siguruar punësim në sektorin privat: shoqëria (16.1%), lidhjet familjare (14.5%), ryshfeti (4.1%), përkatësia partiake (3.6%), paraqitja e jashtme (2.6%) dhe, në masë më të vogël, gjinia (0.4%).

Ngjashëm me anketat e mëparshme, meshkujt (57.2%) kanë më shumë besim në punësimin në baza meritore në sektorin privat sesa femrat (50.5%). Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike treguan se komunitetet tjera të Kosovës (58.5%) kishin më shumë besim në punësimin në sektorin privat sesa shqiptarët e Kosovës (52.9%) dhe serbët e Kosovës (52.7%).




FIGURA 8 Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik kundrejt sektorit privat

PERCEPTIMET PËR KORRUPSIONIN NË SHKALLË TË GJERË

Mesatarisht, 25.2% e të anketuarve pohuan se e perceptojnë që korrupsioni në shkallë të gjerë është i pranishëm në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë, krahasuar me 23.5% në prill 2023 dhe 21.1% në nëntor 2022.

Arsimi (shkollat, universitetet) është perceptuar si më pak i korruptuar me 17.2% të të anketuarve që besojnë se ka prani të korrupsionit në shkallë të gjerë, ndjekur nga Policia e Kosovës (17.9%) dhe Organizatat Ndërkombëtare (19.6%). Organizata më e korruptuar është perceptuar të jetë Dogana, me 39% të të anketuarve që besojnë se ka prani të korrupsionit në shkallë të gjerë.

Ndryshimet më të mëdha në perceptimet për korrupsionin në shkallë të gjerë janë vërejtur në institucionet e mëposhtme: Policia e Kosovës (17.9% krahasuar me 7.3% në prill 2023) dhe komunat (21.7% krahasuar me 15.8% në prill 2023). Është vërejtur një rënie pozitive e perceptimit për korrupsionin në shkallë të gjerë në gjykata (28.8% krahasuar me 37.7% në prill 2023).

	maj-19	nën-19	prill-20	dhje-20	maj-21	prill-21	prill-22	nën-22	maj-23	nën-23	Trendi
Shëndetësia (spitalet dhe qendrat e mjekësisë familjare)	25.10%	33.40%	11%	25%	22.90%	18.80%	18.10%	18.60%	20.50%	24.60%	
KEDS	40.70%	38.90%	27.30%	28.70%	26.10%	25.80%	26.50%	24.50%	28.40%	25.60%	
KEK				27.50%	25.30%	25.80%	26.70%	23.00%	26.10%	25.60%	
Gjykatat	30.70%	42.00%	24.50%	31.60%	32.50%	27.70%	27.90%	30.80%	37.70%	28.80%	
Doganat	29.30%	41.40%	30.60%	39.20%	34.30%	32.30%	36.20%	26.90%	35.80%	39.00%	
Administrata qendrore/qeveria	36.70%	35.30%	20.80%	29.50%	23.10%	19.50%	13.90%	20.10%	25.30%	24.90%	
AKP (Agjencia Kosovare e Privatizimit)	40.70%	48.10%	36.60%	39.00%	39.30%	29.40%	32.60%	28.80%	33.70%	30.70%	
Komunat (qeverisja lokale)	25.80%	29.80%	13.30%	24.70%	20.40%	19.10%	16.30%	18.40%	15.80%	21.70%	
Arsimi (shkollat, Universiteti)	20.70%	26.10%	13.60%	19.50%	15.10%	16.80%	12.10%	14.30%	16.90%	17.20%	
ATK (Administrata Tatimore e Kosovës)	35.30%	42.20%	18.90%	30.20%	27.40%	28.80%	25.40%	24.10%	21.20%	26.40%	
PTK	44.20%	40.80%	37.90%	33.20%	31.60%	23.70%	25.90%	25.30%	25.40%	23.50%	
Bankat	33.80%	34.10%	18.90%	28.10%	22.90%	22.20%	20.50%	14.70%	20.70%	24.80%	
Organizatata ndërkombëtare	19.50%	23.60%	5.50%	23.80%	15.70%	17.60%	14.00%	12.20%	14.10%	19.60%	
Policia e Kosovës (PK)	17.00%	20.70%	9.80%	15.30%	14.00%	20.50%	14.00%	13.50%	7.30%	17.90%	

TABLA 4 Perceptimet për prevalencën e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në Kosovë

Për ta kuptuar se çka e ka formësuar perceptimin për korrupsionin në shkallë të gjerë, të anketuarit u pyetën për arsyet e vlerësimit për praninë e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë. Ngjashëm me anketën e mëparshme, të dhënat e nëntorit 2023 treguan se informacioni përmes mediave është përgjigja kryesore për 63.7% e të anketuarve. Gjithsej 30.5% e të anketuarve deklaruan se bisedat me të afërmit dhe miqtë e formojnë bazën e opinionëve të tyre në lidhje me shtrirjen e korrupsionit, ndërsa vetëm 5.5% e të anketuarve pohuan se në opinionet e tyre për korrupsionin në shkallë të gjerë kanë ndikuar përvojat e tyre personale.




FIGURA 9 Arsyet e të anketuarve për vlerësimin e tyre për shtrirjen e korrupsionit në Kosovë

QËNDRIMET KUNDREJT VOTIMIT

Anketa e opinionit e nëntorit 2023 hulumtoi edhe qëndrimet ndaj votimit të qytetarëve të Kosovës. Ngjashëm me anketën e opinionit të prillit 2023 (32.7%), gjithsej 32.8% e të anketuarve deklaruan se besojnë se vota e tyre mund ta ndryshojë situatën politike në Kosovë. Ndërsa 36.3% konsiderojnë se vota e tyre nuk mund ta ndryshojë situatën politike dhe 27.9% mendojnë se e ndryshon deri diku. Gjithsej 2.9% deklaruan se nuk e dinin nëse vota e tyre mund të ndikojë në ndryshim.




FIGURA 10 Perceptimi i të anketuarve nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë

Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë treguan rritje të besimit mes meshkujve në lidhje me fuqinë e votës së tyre për të ndikuar në ndryshime, krahasuar me prillin 2023. Ndërkohë që 36.3% (34.7% në prill 2023) e meshkujve konsiderojnë se vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, 29.2% (30.7% në prill 2023) e femrave e mendojnë të njëjtën gjë. Gjithsej 37.7% e meshkujve dhe 35.1% e femrave besojnë se vota e tyre nuk mund të sjellë ndryshime, ndërsa 24.1% e meshkujve dhe 31.8% e femrave mendojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime deri diku.




FIGURE 11 Perceptimi i meshkujve dhe femrave nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë

Të dhënat e zbërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë rritje të besimit të komuniteteve të Kosovës tek zgjedhjet si mekanizëm për ndryshim, dhe rënie në mesin e serbëve të Kosovës. Gjithsej 35.5% e shqiptarëve të Kosovës (35% në prill 2023), të ndjekur nga 30.5% e komuniteteve tjera të Kosovës dhe 7.6% e serbëve të Kosovës (3.8% në prill 2023), konsiderojnë se vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë. Ndërkohë që gjithsej 46.2% e serbëve të Kosovës nuk besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime (56.2% në prill 2023), të njëjtën gjë e mendonin edhe 34.8% e shqiptarëve të Kosovës (32.4% në prill 2023) dhe 34.5% e komuniteteve tjera të Kosovës (51.4% në prill 2023).




FIGURA 12 Perceptimi i komuniteteve të ndryshme nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë

Anketa e nëntorit 2023 i pyeti të anketuarit edhe për gjasat që të votojnë nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin së shpejti. Të dhënat treguan ulje të gjasave për të votuar në mesin e të anketuarve. Gjithsej 72.8% e të anketuarve pohuan se do të votonin nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin së shpejti, krahasuar me 77.56% në prill 2023. Gjithsej 14.6% e anketuarve deklaruan se nuk do të votonin nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin së shpejti, krahasuar me 11.4% në prill 2023.

Në mënyrë të ngjashme, të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë treguan ulje të gjasave për të votuar si të meshkujt ashtu edhe të femrat. Gjithsej 74.7% e meshkujve dhe 71.3% e femrave thanë se do të votonin nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin së shpejti, krahasuar me përkatësisht 89.6% dhe 86.8%. Teksa 15.7% e femrave deklaruan se nuk do të votonin, 13.4% e meshkujve e pohuan të njëjtën gjë.

Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se pjesëtarët e komuniteteve tjera të Kosovës (76.50%) kanë më shumë gjasa të votojnë nëse zgjedhjet do të mbaheshin së shpejti, ndjekur nga shqiptarët e Kosovës (73.90%) dhe serbët e Kosovës (64.76%). Të dhënat e nëntorit 2023 të zbërthyer sipas përkatësisë etnike, treguan ulje të gjasave për të votuar në të gjitha grupet etnike krahasuar me prillin 2023, kur këto shifra ishin përkatësisht 83.3% e pjesëtarëve të komuniteteve tjera të Kosovës, 81.4% e serbëve të Kosovës dhe 77.2% e shqiptarëve të Kosovës.

DREJTËSIA TRANZICIONALE

Në dy edicionet e fundit, Pulsit Publik e ka mbuluar edhe drejtësinë tranzicionale. Të anketuarit u pyetën për opinionet e tyre për aspekte të ndryshme të drejtësisë tranzicionale. Gjithsej 59.3% e të anketuarve (44.2% në prill 2023) pohuan se trashëgimia e konfliktit dhe e shkuara kolektive e Kosovës nuk pasqyrohen profesionalisht në media, ndërsa 21.1% (38.1% në prill 2023) e të anketuarve pohuan se trashëgimia e konfliktit dhe e shkuara kolektive pasqyrohen profesionalisht në media. Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike treguan se një pjesë më e madhe e shqiptarëve të Kosovës (59.4%) besonin se trashëgimia e konfliktit dhe e shkuara kolektive e Kosovës nuk pasqyrohen profesionalisht në media, ndjekur nga 55.2% e serbëve të Kosovës dhe 52% e pjesëtarëve të komuniteteve tjera të Kosovës.




FIGURA 13 Opinioni i të anketuarve për pasqyrimin profesional nga mediat të trashëgimisë së konfliktit dhe të shkuarës kolektive të Kosovës

Të anketuarve iu kërkua opinioni i tyre për “Marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë” (në tekstin e mëtejme “marrëveshja”). Gjetjet treguan një rritje të përqindjes së të anketuarve që besonin plotësisht ose besonin se marrëveshja do të ndikojë pozitivisht në jetën e qytetarëve të Kosovës. Gjithsej 60% e të anketuarve pohuan se marrëveshja do të ketë efekt pozitiv, krahasuar me 58% në prill 2023. Teksa 29.4% e të anketuarve janë shprehur se besojnë se marrëveshja do të ketë efekt pozitiv deri diku, 3.9% janë shprehur se nuk do të ketë, krahasuar me përkatësisht 29.9% dhe 7.5% në prill 2023.




FIGURE 14 Perceptimi i të anketuarve për ndikimin tek populli i Kosovës nga Marrëveshja për Rrugën drejt Normalizimit të Marrëdhënieve

Shumica e të anketuarve (58.8%) pohuan se besojnë plotësisht ose besojnë se marrëveshja do ta ndihmojë Kosovën në rrugën e saj drejt BE-së. Të dhënat e zërthyer sipas përkatësisë etnike treguan se 59.9% e shqiptarëve të Kosovës (57.8% në prill 2023) dhe 67.5% e pjesëtarëve të komuniteteve tjera të Kosovës (65% në prill 2023) besonin plotësisht ose besonin se marrëveshja do ta ndihmonte Kosovën në rrugën e saj drejt BE-së, ndërsa vetëm 25.3% e serbëve të Kosovës (22.4% në prill 2023) e besonin të njëjtën gjë. Të dhënat e zërthyer sipas gjinisë treguan se meshkujt (60.7%) ishin më optimistë se marrëveshja do ta ndihmojë Kosovën në rrugën e saj drejt BE-së, krahasuar me femrat (57%).

Gjithsej 39.1% e të anketuarve pohuan se besojnë se marrëveshja do të kontribuojë për paqen afatgjatë në Kosovë, 36.9% pohuan se do të kontribuojë deri diku, 16.4% se nuk do të kontribuojë, dhe 7.9% e të anketuarve nuk e dinin ose refuzuan të përgjigjeshin. Të dhënat e zërthyer sipas përkatësisë etnike treguan perceptime të ndryshme ndërmjet komuniteteve të ndryshme në lidhje me opinionin e tyre për ndikimin e marrëveshjes në paqen afatgjatë në Kosovë. Gjithsej 40.5% e shqiptarëve të Kosovës (38.5% në prill 2023) dhe 36% e pjesëtarëve të komuniteteve tjera të Kosovës (36.5% në prill 2023) besonin se marrëveshja do të kontribuonte për paqen afatgjatë në Kosovë, ndërsa 25.2% e serbëve të Kosovës (10% në prill 2023) e besonin të njëjtën gjë. Gjithsej 28.1% e serbëve të Kosovës, 16.2% e shqiptarëve të Kosovës dhe 16% e pjesëtarëve të komuniteteve tjera të Kosovës nuk janë optimistë se marrëveshja do të kontribuojë për paqen afatgjatë në Kosovë. Gjithsej 41.9% e serbëve të Kosovës, 39.5% e pjesëtarëve të komuniteteve tjera të Kosovës dhe 36% e shqiptarëve të Kosovës besonin se marrëveshja do të kishte deri diku efekt pozitiv në paqen afatgjatë në Kosovë.




FIGURA 15 Perceptimi i të anketuarve rreth çështjes nëse Marrëveshja për Rrugën drejt Normalizimit të Marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do ta forcojë kohezionin social në Kosovë, zërthyer sipas përkatësisë etnike

Të dhënat e zbërthyera sipas gjinisë treguan se meshkujt (42%) janë më pozitivë sesa femrat (36.2%) se marrëveshja do të ketë efekt pozitiv në paqen afatgjatë në Kosovë. Rrjedhimisht, më shumë femra (16.9%) besojnë se marrëveshja nuk do të ndikojë pozitivisht në paqen afatgjatë në Kosovë, krahasuar me meshkujt (15.9%). E njëjta përqindje e meshkujve dhe femrave besonin se marrëveshja do të ketë deri diku efekt pozitiv në paqen afatgjatë.

METODOLOGJIA

Gjetjet e paraqitura në këtë përmbledhje bazohen në anketën e opinionit me 1,306 të anketuar në Kosovë mbi moshën 18 vjeçare, të realizuar nga 8 deri më 27 nëntor 2023. Mostra përfshiu numër të njëjtë të meshkujve dhe femrave nga të gjitha komunat dhe rajonet e Kosovës, duke i mbuluar si zonat urbane ashtu edhe ato rurale. Në aspektin e përfaqësimit etnik, mostra i ka përfshirë 896 shqiptarë të Kosovës, 210 serbë të Kosovës dhe 200 pjesëtarë të komuniteteve tjera të Kosovës (ashkali të Kosovës, boshnjak të Kosovës, egjiptas të Kosovës, goranë të Kosovës, romë të Kosovës, dhe turq të Kosovës). Anketa u krye në bazë të marrjes së mostrave me probabilitet rastësor në etapa të shumëfishta, dhe u krye përmes intervistave sy më sy. Mostra është përfaqësuese e ekonomive familjare në Kosovë.³

PESHIMI I TOTALEVE TË POPULLATËS

Anketat e Pulsit Publik marrin mostra më të mëdha të pakicave në mënyrë që të dhënat të mund të zërthehen sipas përkatësisë etnike. Megjithatë, kur bëhen përlogaritjet për totalet, ekipi i Pulsit Publik e bën peshimin e të dhënave sipas shifrave aktuale të popullatës. Që nga viti 2002, janë përdorur përqindjet e mëposhtme për peshimin e totaleve të popullsisë:

- Shqiptarë të Kosovës: 88%;
- Serbë të Kosovës: 6%;
- Pjesëtarët e komuniteteve tjera të Kosovës: 6%.

³ Në raport përdoren termat përqindje dhe pikë përqindje. Një pikë përqindje është ndryshimi numerik mes dy përqindjeve; ndërsa përqindja është raporti i shprehur si fraksion i 100. Përqindja i referohet shkallës së ndryshimit, ndërsa pika e përqindjes e bën matjen e sasisë reale të ndryshimit.

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 dhe të dhënave zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, përbërja etnike aktuale në Kosovë është siç vijon:

Përkatësia etnike	Gjithsej popullsia	Përqindja e popullsisë totale
Shqiptarë të Kosovës	1,616,869	92.93
Serbë të Kosovës	25,532	1.47
Turq të Kosovës	18,738	1.08
Boshnjakë të Kosovës	27,533	1.58
Goranë të Kosovës	10,265	0.59
Romë të Kosovës	8,824	0.51
Ashkali të Kosovës	15,436	0.89
Egjiptas të Kosovës	11,524	0.66
Të tjerët, refuzuan të deklarohen dhe nuk janë në dispozicion	5,104	0.29
Gjithsej	1,739,825	100.00

Nëse këto shifra do të ndiqeshin për Anketat e Pulsit Publik, peshimi do të ishte si më poshtë:

- Shqiptarë të Kosovës: 93%;
- Serbë të Kosovës: 2%;
- Pjesëtarë të komuniteteve tjera të Kosovës: 5%.

Megjithatë, marrë parasysh se serbët e Kosovës në pjesën veriore të Kosovës nuk morën pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011, së bashku me vlerësimin e përgjithshëm se shkalla e pjesëmarrjes së serbëve në pjesën tjetër të Kosovës është më e ulët, u vlerësua se duhet t'i shtojmë edhe 34,000 serbë të tjerë të Kosovës, duke e sjellë në 59,532 numrin total të serbëve të Kosovës të konsideruar për qëllimet e këtij studimi. Ky veprim gjithashtu e rriti popullsinë e përgjithshme të Kosovës në 1,773,825. Kur merren në konsideratë këto ndryshime, peshimi në anketat e Pulsit Publik është bërë si në vijim:

- Shqiptarë të Kosovës: 92%;
- Serbë të Kosovës: 4%;
- Pjesëtarët e komuniteteve tjera të Kosovës: (ashkali të Kosovës, boshnjakë të Kosovës, egjiptas të Kosovës, goranë të Kosovës, romë të Kosovës, dhe turq të Kosovës): 4%.

PËRLLOGARITJA E INDEKSEVE

Indeksi i Indeksit të Demokratizimit (ID) është një mesatare e përbërë e bazuar në nivelin e pajtimit apo mospajtimit të të anketuarve me zhvillimet vijuese në Kosovë: shkalla e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, monitorimi i Kuvendit, performanca e institucioneve qendrore, pavarësia e sistemit gjyqësor, liria e shprehjes dhe mediave, ekzistenca e një shoqërie civile mbikëqyrëse në Kosovë, Kushtetuta dhe ligjet e bazuara në të drejtat e njeriut, dhe nëse institucionet lokale dhe ato ekzekutive qendrore punojnë në përputhje me prioritetet e qytetarëve. ID-ja është matje e vazhdueshme e cila shkon nga 0 në 3, ku rezultati prej 0 deri në 1.5 do të thotë që shumica e të anketuarve konsiderojnë se demokratizimi nuk është në rrugën e duhur, kurse rezultati prej 1.5 deri në 3 do të thotë që shumica e të anketuarve pajtohen se demokratizimi është në rrugën e duhur.

Indeksi i Besueshmërisë Ekonomike (IBE) është një mesatare e përbërë e cila përlllogaritet në bazë të vlerësimit të të anketuarve për kushte të favorshme ose të pafavorshme ekonomike në Kosovë. Konkretisht, të anketuarit i vlerësojnë kushtet në vijim: pritshmëritë në lidhje me të hyrat totale të familjeve të tyre, kushtet e punësimit për gjashtë muajt e ardhshëm, dhe vlerësimin e kushteve aktuale të biznesit dhe punësimit. IBE-ja është një matje e vazhdueshme me vlera që shkojnë nga 0 në 3, ku harku prej 0 deri në 1.5 tregon një vlerësim të pafavorshëm të gjendjes ekonomike nga shumica e popullatës, kurse harku prej 1.5 deri në 3 tregon një vlerësim të favorshëm nga shumica.

